



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:114685  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05437691

C.nr.911/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit R.S.D. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, kundër të paditurve: M.M.P.H. dhe M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë, të cilat me autorizim i përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 3,055.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 12.03.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e parakohshme, padia C.nr.911/2021 e datës 09.06.2021, parashtruar nga paditësi R.S.D. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, kundër të paditurve: M.M.P.H. dhe M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

### A r s y e t i m

Paditësi R.S.D. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurve: M.M.P.H. dhe M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë, të cilat me autorizim i përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 3,055.00 euro.

Të paditurat, përmes të autorizuarës së tyre, më datë 10.01.2024 kanë paraqitur përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu kanë theksuar se asnjë dispozitë ligjore nuk e parashihet detyrimin e të paditurve për kompensimin e dëmit dhe se paditësi nuk ka ndjekur procedurat e kërkuara me dispozita ligjore, me qëllim të vlerësimit të shkaktarit të dëmit dhe lartësisë së tij.

Sipas nenit 54 par. 1 të Ligjit nr.02/L-53 për gjuetinë, përcaktohet që “për dëmin të cilin e shkaktojnë kafshët e egra që mund të gjuhen gjatë sezonës së hapur të gjuetisë, përgjegjës është menaxheri i vendgjuetisë në të cilën kafsha përherë jeton, me kusht që i dëmtuari ka ndërmarrë masat e parapara për pengimin e demit nga kafsha e egër, të cilat ka qenë i detyruar ti ndërmarri në harmoni me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra sipas tij”. Në vazhdim, me nenin 2 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 për dëmet nga kafshët e egra dhe në kafshë të egra parashihet që “pronarët dhe shfrytëzuesit e tokave, bagëtisë dhe menaxherët e vendgjuetive të cilëve u është shkaktuar dëmi, paraqesin fletëdenoncimin organit kompetent komunal në të cilin rajon është shkaktuar dëmi”. Në paragrafin 2 të nenit të lartcekur të Udhëzimit Administrativ në fjalë, theksohet se “fletëdenoncimi për paraqitjen e dëmit, bëhet menjëherë, respektivisht kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin, por gjithnjë në kohën kur dëmi mund të konstatohet dhe vlerësohet objektivisht dhe me profesionalizëm”. Pastaj, në nenin 3 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 thuhet që “dëmet e shkaktuara nga kafshët e egra dhe në kafshët e egra në vendgjueti, vlerësohen nga komisioni i cili formohet nga komuna përkatëse për dëmet e

shkaktuara në vendgjuetitë e përbashkëta dhe nga ministria, për dëmet e shkaktuara në vengjuetitë me rëndësi të veçantë-shtetërore. Më tutje, në nenin 4 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 parashihet që “Komisioni është i obliguar që brenda ditës të bëjë konstatimin e shkakut të dëmit dhe vlerësimin e tij”. Në paragrafin 2 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ të lartcekur theksohet që “Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve i përfaqësuar nga ekspertët e gjuetisë, veterines dhe ekspertë të lëmive përkatëse”. Ndërsa, në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 përcaktohet shprehimisht që “nëse për konstatimin dhe kompensimin e dëmit eventual të konstatuar nga Komisioni, nuk arrihet marrëveshja ndërmjet menaxhuesit dhe të dëmtuarit, çështja kalon në gjykatë”.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e lartcekura, ka gjetur se padia e paditësit është e parakohshme. Kjo për faktin se pas shkaktimit të dëmit më datë 30.03.2019, të pretenduar se është shkaktuar nga ariu, paditësi nuk ka paraqitur fletëdenoncimin pranë Komunës së Prizrenit, përkatësisht organit kompetent komunal, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të theksuara më lartë. Po ashtu, paditësi nuk ka ndjekur dhe realizuar asnjërin nga veprimet dhe procedurat e kërkuara, të rregulluara dhe përcaktuara me dispozita ligjore, me qëllim të konstatimit të dëmit të shkaktuar dhe vlerësimin të këtij dëmi. Pra, paditësi pas përpilimit të procesverbalit nga ana e inspektorëve të Komunës së Prizrenit, ka parashtruar padinë pranë kësaj gjykate, me objekt që të kompensohet për dëmin të cilin pretendon se i është shkaktuar nga ariu i murrme më datë 30.03.2019.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimin të shkresave të lëndës, erdhi në përfundim se padia e paditësit C.nr.911/2021 e datës 09.06.2021, është e parakohshme dhe për këtë vendosi ta hedhë poshtë, pasi që paditësi nuk i ka shfrytëzuar mundësitë dhe procedurën e brendshme me qëllim të vlerësimin dhe realizimit të dëmit e cila procedurë është parakusht për të kërkuar mbrojtje të mëvonshme gjyqësore siç parashihet me nenin 6 Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 për dëmet nga kafshët e egra dhe në kafshë të egra.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 393 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) ku thuhet se “gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë lidhur me të pasi të arrijë përgjigja në padi e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore”.

Në bazë të fakteve dhe arsyeve të theksuara më lartë, në kuptim të nenit 393 dhe 142 par. 5 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.911/2021 të datës 12.03.2024

Gjyqtari,  
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.